



RAPORT

ZBATIMI I LIGJIT “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”

(Ligj nr.9669, datë 18.12.2006)

Monitorimi i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes/Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe rasteve të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të mbështetura me ndihmë ligjore falas, nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL).

Periudha e monitorimit: 01.06.2009-01.06.2010

Përgatitën: Prof.Dr. Aurela Anastasi, Av. Besa Saraçi, Av. Aurela Bozo

*Përgatitja e raportit u realizua në kuadrin e projektit “Rritja e aksesit në drejtësi për gratë në nevojë”,
zbatuar nga QNL.*

Me ndihmën dhe mbështetjen e Civil Rights Defenders

Tiranë, Nëntor 2010

Falenderime:

Një falenderim i veçantë shkon për Civil Rights Defenders, i cili mundësoi përgatitjen dhe publikimin e këtij raporti monitorues.

Autorët dëshirojnë të falenderojnë anëtarët e skuadrave probono Juvena Puka, Artil Mandro, Krisi Anastas, Elsona Lumani, Arjan Qyrku dhe Valmira Jorgji, si dhe avokaten mbikqyrëse Iris Aliaj, për kontributin në përgatitjen e këtij raporti.

Përmbajtja e lëndës:

Kreu I- Qëllimi dhe metodologjia e studimit.....	4
Kreu i II- Roli i aktorëve përgjegjës në procesin civil për parandalimin e dhunës në familje.....	5
1. Aksesit i viktimave të dhunës në procesin gjyqësor civil dhe roli i gjyqtarit në parandalimin e dhunës në familje..	5
2. Mbështetja e viktimave për denoncimin e dhunës.....	8
3. Masat mbrojtëse të dhëna nga gjykata.....	8
4. Procedurat gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.....	9
5. Shpejtësia e gjykimit.....	10
6. Të drejtat e viktimës së dhunës në familje gjatë procesit gjyqësor civil.....	11
7. Çështje të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.....	12
8. Profili social i viktimës dhe dhunuesit.....	12
Kreu III	
Sugjerime.....	20

I. Qëllimi dhe metodologjia e studimit

Studimi u mbështet në monitorimin e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhrave mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes për periudhën kohore 01.06.2009-01.06.2010. Ai ka për qëllim të evidentojë, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore dhe praktikave gjyqësore të monitoruara nga avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, aksesin në gjykatë dhe në autoritetet e tjera të përcaktuara nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për mbrojtjen nga dhuna në familje. Në këtë mënyrë, njëkohësisht nxjerrim në dukje, disa aspekte të rëndësishme të zbatimit të ligjit.

Në këto kushte, e konsideruam mjaft të dobishme të monitorojmë vendime të gjykatës së shkallës së parë, Tiranë, për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, me qëllim që të arrijmë në konkluzione, të cilat mund të shërbejnë për të evidentuar rolin e aktorëve përgjegjës në identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe parandalimin e saj, si dhe për të njohur dinamikën e zbatimit të ligjit kundër dhunës në familje nga aktorët përgjegjës. Ky monitorim hedh dritë edhe në një sërë aspektesh të tjera të rëndësishme, si fjala vjen, na lejon të kuptojmë se si ndihmon zbatimi i ligjit për mbrojtjen e familjarëve; të njohim format dhe mënyrat e ushtrimit të dhunës në familje dhe shkaqet e kësaj dhune; të njohim se si ka funksionuar rrjeti institucional kundër dhunës në familje, etj.

Monitorimi u organizua në dy drejtime kryesore:

1. mbi vendimet gjyqësore për urdhërat e mbrojtjes dhe urdhërat e menjëhershëm të mbrojtjes të dhëna nga Gjykata e rrethit gjyqësor, Tiranë,
2. mbi praktikatat e ndjekura nga avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, gjatë asistencës ligjore falas, të ofruar për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, në mënyrë të veçantë, për gratë dhe fëmijët.

Në këtë mënyrë, u monitoruan 406 vendime gjyqësore, mbi bazën e pyetsorëve të përgatitur nga ekspertët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Pyetsorët u hartuan mbi dy dimensione: social dhe tekniko-juridik. Kjo bëri të mundur që gjatë monitorimit, të nxjerrim një varg të dhënash e konkluzionesh për çështjet e problemet sociale që evidentohen nga vendimet e gjykatave, si dhe një sërë konstatimesh mbi mënyrën dhe teknikën e zbatimit të ligjit nga gjykatat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes urdhrave të mbrojtjes.

Pyetsorët u pasuruan me elementë të rinj, krahasuar me monitorimet e mëparshme si: organet ku është referuar vendimi për zbatim, format e denoncimit drejtpërdrejt ose me telefon, “shkaqet” e dhunës, organet ku është denoncuar dhuna, shoqërimi i viktimës nga policia gjatë gjykimit, nëse denoncimi është kryer nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare apo nga komuniteti, ku është bazuar gjykata në lëshimin e vendimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes, në afatet procedurale të zbatuara për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, si dhe nëse subjektet që legjitimohen për paraqitjen e kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje e kanë ushtruar këtë të drejtë.

Metoda krahasimore, me të dhënat e evidentuara gjatë monitorimit me të njëjtin objekt për periudhën 01.06.2007-30.04.2008, na ndihmoi për të arritur në disa konkluzione të rëndësishme. P.sh., vihet re se, ka një rritje të dukshme të numrit të kërkesave përpara gjykatës për urdhrin e mbrojtjes, gjatë kësaj periudhe, krahasuar me periudhën, monitoruar më parë nga QNL¹.

Kryerja e monitorimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ndihmon për rishikimin e vazhdueshëm të efektivitetit aktual të masave dhe kryerjen e modifikimeve nëse janë të nevojshme. Rishikimi i ligjeve ekzistuese kombëtare dhe i studimeve gjithëpërfshirëse është i nevojshëm. Problematikat e evidentuara gjatë monitorimit ravijëzojnë nevojat për ndërhyrje.

¹Shih raportin “Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” për periudhën 01.06.2007-31.04.2008, Tiranë 2008.

Një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e raportit monitorues ofruan gjashtë anëtarë të skuadrave probono, të cilët janë trajnuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe vazhduese mbi zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.” Studentët kryen një punë voluminoze për evidentimin e të dhënave që rezultojnë nga vendimet e gjykatave, duke plotësuar formularët paraprakë që ekspertët e Qendrës, përgatitën paraprakisht. Këto të dhëna u pasqyruan në mënyrë të tillë që të lejohej krahasimi i tyre me të dhënat e monitorimit të një viti më parë, si dhe disa të dhëna u mbodhën rishtazi, bazuar në problemet që Qendra ka hasur gjatë veprimtarisë së saj për ndihmën ligjore. Krahasimi i të dhënave dhe evidentimi i disa të dhënave të reja, ndihmoi në nxjerrjen e konkluzioneve dhe sugjerimeve të dobishme.

Kreu II. ROLI I AKTORËVE PËRGJEGJËS NË PROCESIN CIVIL PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Nga 1 Qershori i vitit 2007, kur hyri në fuqi ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (nr.9669, dt. 18.12.2006), deri më sot, praktika gjyqësore për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes dhe urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes ka dëshmuar se, aktorët përgjegjës në zbatimin e ligjit përbëjnë një faktor të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje. Mjetet mbrojtëse të sanksionuara nga ky ligj, për shkak të natyrës së tij publiko-civile, ngërthejnë një sërë detyrimesh për institucionet shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse që japin shërbime në këtë fushë. Sidoqoftë, roli i gjyqtarit spikat si një aktor kyç në kuadër të bashkëpunimit institucional, për përmbushjen e qëllimeve të ligjit. Nga pikëpamja juridike, zbatimi i ligjit nga gjyqtari civil ka bërë të mundur të realizohet edhe qëllimi i kodit të Familjes, i cili parashikoi masat kundër dhunës në familje, (nenet 61, 62), por për disa vjet me radhë, nuk njohu rrugën e zbatimit nga gjykatat.

Paraprakisht theksojmë se, nga monitorimet e vendimeve gjyqësore² rezulton që fenomeni i dhunës në familje mbetet një fenomen i përhapur, konkluzion i cili ka dalë edhe nga të dhënat statistikore që paraqiten nga INSTAT pas hyrjes në fuqi të këtij ligji³.

1. **Aksesi i viktimave të dhunës në procesin gjyqësor civil dhe roli i gjyqtarit në parandalimin e dhunës në familje.** Një nga mjetet ligjore që ofron ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është aksesi i viktimave të dhunës në familje në procesin civil, për të kërkuar lëshimin e urdhërit të mbrojtjes (UM) dhe të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM). Sidoqoftë, ndjekja e çështjes në procesin civil, nuk i ndalon palët që të ndjekin edhe procesin penal për veprime ose mosveprime të dhunës në familje, që përbëjnë figura të veprave penale. Duhet theksuar se, legjislacioni penal shqiptar nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë që dënon dhunën në familje, duke ruajtur në përgjithësi një vlerë shumë të ulët penale të dhunës së përditëshme familjare⁴. Për këtë arsye, aktet e dhunës në familje ndiqen dhe dënohen mbi bazën e dispozitave të përgjithshme, që nuk mbajnë parasysh marrëdhëniet familjare midis viktimës dhe shkaktarit. Në këto kushte, aksesi i viktimave në procesin civil për të kërkuar urdhrat civilë të mbrojtjes, është një mjet i dobishëm për parandalimin e dhunës.

Vetëm gjatë periudhës një-vjeçare Qershor 2009-Qershor 2010, pranë Gjykatës së Shkallës së I-rë Tiranë, janë paraqitur 406 kërkesa për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ndërkohë, një vit më parë (Maj 2008-Maj 2009), u paraqitën 448 kërkesa të tilla. Sidoqoftë, nga 406 kërkesa, vetëm në 128 raste, Gjykata e Tiranës ka dhënë një vendim përfundimtar duke vendosur në 23.89 % të rasteve pranimin e kërkesës, në 3.44 % të rasteve pranimin e pjesshëm të kërkesës, në 0.24 % të rasteve refuzimin e kërkesës, në 3.44 % të rasteve rrëzimin e kërkesës dhe në 0.49 % të rasteve anulimin e UMM.

Vendimi i Gjykatës						
Vendime Gjithsej	Pranim Kërkese	Pranim i Pjesshëm	Pushim Gjykimi	Anullim i UMM	Refuzim Kërkese	Rrëzim Kërkese
406	97	14	278	2	1	14

²Shih: Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2009. (botuar në website: <http://www.qag-al.org>).

³ Referuar Vrojtimet Kombëtar të INSTAT, “Dhuna në familje në Shqipëri”, 2009, rezulton se: të paktën 56% e grave të anketuara kanë përjetuar një nga format e dhunës në familje të matura në vrojtim; Rezultoni sipas të njëjtit vrojtim se nga 991 fëmijët e anketuar, 57.7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes.

⁴ Shih më gjerë: “Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri” (raport i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë), OSBE, 2006, fq. 120-123

Në %	23.89 %	3.44 %	68.47 %	0.49 %	0.24%	3.44%
------	---------	--------	---------	--------	-------	-------


Tabela nr.1

Në 278 rastet e tjera, Gjykata e Shkallës së I-rë Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit. Nga 278 vendime pushimi, në 162 prej tyre, çështja është pushuar për shkak të mos paraqitjes së viktimës, palë paditëse dhe në 116 rastet e tjera, çështja është pushuar për shkak se pala paditëse hoqi dorë nga gjykimi. Në vendimet e pushimit, nga arsyetimi i vendimit rezulton se, në 32 raste, është lëshuar Urdhëri i Menjëhershëm i Mbrojtjes, porse në vërtetimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, viktimja është tërhequr, gjë që ka sjellë pushimin e gjykimit të çështjes.

Pushime gjykimi		
Vendime Gjithsej	Për mosparaqitje të palës paditëse	Pala paditëse hoqi dorë
278	162	116
Në %	58.27 %	41.72 %

Tabela nr.2

Të dhënat në lidhje me pushimin e vendimeve për lëshimin e UM/UMM paraqiten në grafikun në vijim.



Grafiku nr.1

Shkaqet për pushimin e gjykimit. Sikurse evidentohet nga shifrat e lartpërmendura, pavarësisht se ka një tendencë të lartë të numrit të kërkesave drejtuar gjykatës në procesin civil, në të njëjtën kohë, vihet re një numër i madh i pushimeve të gjykimit. Është e vërtetë se ka një rënie të këtij numri në raport me 1 vit më parë në periudhën objekt monitorimi⁵, por sidoqoftë, nr. i rasteve të pushimit, mbetet sërish i lartë. Pushim i gjykimit në terma më të

⁵ QNL, Raport, Zbatimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", për periudhën objekt monitorimi 30.04.2008-01.06.2009. Nga ky monitorim rezultoi se është pushuar gjykimi në 329 raste (nga 448 vendimet objekt monitorimi) ose në 73.43 %. Në 46.20% është pushuar

tjeshtë do të thotë që shqyrtimi i çështjes të mbetet në mes dhe nuk kemi ndonjë vendim përfundimtar të gjykatës. Në lidhje me shkaqet e pushimit, mund të arrijmë në disa konkluzione vetëm përmes përvojave që kemi hasur në praktikën e avokateve të Qendrës për nisma ligjore qytetare, si dhe për atë që mund të kuptojmë nga arsyetimi i vendimit të gjykatave. Si rregull, gjyqtarët i pasqyrojnë në vendim shkaqet e pushimit të gjykimit, të cilat lidhen veçanërisht me mosparaqitjen e paditësit/es, ose me tërheqjen e tij/saj nga gjykimi.

Megjithatë, në disa raste, gjyqtari është shprehur fare shkurt, duke iu referuar për hollësi të mëtëjshme kërkesës së paditësit/es në dosje. Ne mendojmë se është i nevojshëm prezantimi i hollësishëm i shkaqeve të pushimit gjatë arsyetimit të vendimit. Kjo ndihmon që përmes monitorimit të vendimeve, të arrijmë në konkluzione të sakta në lidhje me to, me qëllim marrjen e masave të nevojshme⁶.

Së pari, numri i lartë i pushimeve të çështjeve, lidhet me efektin që sjell tek dhunuesi përdorimi i mjetit ligjor. Paraqitja e një kërkesë për urdhër mbrojtjeje në gjykatë mund të përbëjë një mjet për parandalimin e dhunës së ushtruar në marrëdhënie familjare, duke e bërë dhunuesin të reflektojë ose mund ta “frikësojë” të paditurin, ose ta detyrojë atë që të mos ushtrojë dhunë, ose të reduktojë shkallën e dhunës së ushtruar ndaj viktimës. Kjo mund ta bëjë viktimën të besojë se situata po përmirësohet dhe ta tërheqë denoncimin ose të mos paraqitet në seancën e shqyrtimit të kërkesë- padisë së paraqitur prej saj.

Sidoqoftë, eksperiencia e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare në mbështetje të viktimave të dhunës ka treguar se dhuna ka ciklet e saj nëpër të cilat ajo kalon dhe të cilat, ia lënë vendin njëra tjetrës. Ndodh shpesh që viktima e dhunës në familje të tërhiqet për shkak të pajtimit me dhunuesin, por të kthehet përsëri në një dhunë që përsëritet me intervale. P.sh., Avokatet e Qendrës kanë mbështetur me mbrojtje ligjore falas disa herë të njëjtin rast, si rezultat i heqjes dorë të viktimës nga ndjekja gjyqësore e çështjes tre herë me radhë. *Kështu janë dhënë tre vendime pushimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen me palë M.P dhe P.P me objekt lëshimin e Urdhrit të mbrojtjes, përkatësisht në datat 24.12.2009, 28.04.2010 dhe 19.05.2010. Ky fakt i thjeshtë na bën të mendojmë për faktin se duhet të jemi të vëmendshëm ndaj situatave të pajtimit, pasi shpesh ato paraqiten të gënjeshtërt.*

Në disa raste vihet re se, si shkak për pushimin e gjykimit ka shërbyer edhe pajtimi i palëve. Kështu, p.sh., gjykata ka pushuar gjykimin me arsyetimin se pala jashtëgjyqësisht deklaroi se janë pajtuar. Po, kështu, në ndonjë rast, gjykata ka vendosur përfundimisht zgjidhjen me pajtim të çështjes civile midis palëve, bazuar në nenin 158/b, pika 4 e kodit të Procedurës Civile⁷. Ka edhe raste, kur shprehet në vendim, se në bazë të Kodit të Procedurës Civile, gjykata bëri përpjekjet e saj për pajtim, por pala kërkoi lëshimin e urdhrit të mbrojtjes⁸. Lidhur me sa më sipër, theksojmë se, urdhërat civilë të mbrojtjes nga dhuna në familje, nxirren në bazë e për zbatim të ligjit nr. 9669, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili parashikon një procedurë të posaçme (*ius singularis*). Ky ligj nuk ka vendosur në asnjë rast përpjekjet për pajtim midis palëve, si mjet për gjyqtarin, Kjo nuk është një harresë e tij, por është e qartë që ligjvënësi nuk ka dashur të vendosë në këtë ligj, parimin e pajtimit midis palëve si parim ligjor, por parimin e mbrojtjes ligjore. Në përvojën e shteteve të ndryshme është kritikuar kjo tendencë, pasi pajtimi mund ta detyrojë bashkëshorten t’i kthehet përsëri lidhjes abuzive⁹. Prandaj, mendojmë se, **gjatë lëshimit të urdhrave mbrojtës gjykata nuk ndodhet përpara rastit të zbatimit të kodit të Procedurës Civile për pajtimin midis palëve.**

Së dyti, këto të dhëna na bëjnë të mendojmë se viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare mund të ketë marrë këtë vendim për të kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, edhe si rezultat i frikës së një dhune edhe më ekstreme të ushtruar nga paditësi dhe pasigurisë së saj se, do t’i ofrohet mbrojtja e duhur gjatë kësaj periudhe. Pasiguria dhe

gjykimi i çështjes për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse. Në 27.23 % të rasteve gjykimi i çështjes është pushuar sepse është kërkuar nga pala paditëse.

⁶ Vini re: Të gjitha vendimet që referohen në këtë punim, janë vendime të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë

⁷ Vendimi nr.3977, dt.15.5.2010. të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë

⁸ Vendim nr. 2416, dt. 26.03.2010, vendim nr. 3977, dt.15.05.2010. të Gjyk. së Shkallës së I-rë, Tiranë

⁹ Shih më gjerë: “Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri”, vep.cit., fq. 118

frika e viktimës për një dhunë edhe më ekstreme lidhet edhe me faktin se, sa efektiv është mekanizmi i referimit dhe sa mbrojtje ofron ai për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Së treti, mendojmë që kjo shifër tregon se ka nevojë për një mbështetje më të mirë psiko-sociale dhe ligjore për pjesëtarët e dhunuar të familjes, përpara se ata të vendosin të paraqesin në gjykatë një kërkesë për urdhër mbrojtje, si dhe gjatë procesit të shqyrtimit të saj. Vetëm nëse një viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare do të këshillohet profesionalisht para se ajo të vendosë t’i drejtohet gjykatës, ajo mund të ndërgjegjësohet në lidhje me situatën në të cilën ndodhet dhe mbi përdorimin e mjeteve ligjore që ofron ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, si dhe mbi efektet që këto mjete do të sillnin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Pavarësisht nga numri i lartë i pushimit të gjykimeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, mund të mbetemi në konkluzionin se, **ka një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve për denoncimin e dhunës në familje**.

Njëkohësisht, mund të pranojmë dobinë që ka ky ligj, duke u dhënë mundësinë anëtarëve të familjes që t’i drejtohen gjykatës, në procesin civil, qëllimshëm për marrjen e masave kundër dhunës në familje. Gjithashtu, mund të pranojmë se, bashkëpunimi ndërinstytucional ka ndikuar në rritjen e numrit të kërkesave përpara Gjykatës, porë që shumica e tyre, adresohen kryesisht, nga organet e policisë, si dhe nga aktorët e tjerë të rritit institucional.

2. **Mbështetja e viktimave për denoncimin e dhunës.** Të dhënat nga monitorimi tregojnë se policia vazhdon të jetë aktori kryesor ku është denoncuar dhuna. Në 21.67% të 406 vendimeve objekt monitorimi viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare i janë drejtuar policisë për të denoncuar dhunën, duke e parë atë edhe si një organ të rëndësishëm për mbrojtjen e jetës së viktimave dhe familjarëve të tyre gjatë procesit. Kështu në 4 (katër) raste gjejmë të dhëna nga vendimi, se policia i ka shoqëruar viktimat në gjykatë duke konsideruar se jeta e tyre është në rrezik. 406 vendimet e lëshuara nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, janë një tregues që besimi i target grupit të pjesëtarëve të dhunuar të familjes tek organet e drejtësisë është rritur.

Në këtë kuadër, mbetet të analizohet pikëpyetja se, përse në këto tre vjet të zbatimit të këtij ligji, pranë gjykatës së Shkallës I-rë, Tiranë, nuk ka asnjë kërkesë për urdhër mbrojtjeje nga prokurori. Në vështrim të parë ne mendojmë që kjo lidhet me faktin se, denoncimet e dhunës adresohen fillimisht në polici, e cila paraqet kërkesën përpara gjykatës. Megjithatë, mbetet për t’u monitoruar gjatë hetimit të një vepre penale të dhunës të kryer brenda familjes, nëse lind nevoja që prokurori të kërkojë njëkohësisht edhe urdhrin e mbrojtjes, apo jo. Në këto raste, prokurori nuk duhet të hezitojë ta paraqesë kërkesën dhe gjykata nuk mund ta refuzojë atë, për faktin se çështja është duke u ndjekur penalisht (neni 17, pika 2 e ligjit).

3. Masat mbrojtëse të dhëna nga gjykata. Dinamika e zbatimit të nenit 10 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili parashikon masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, dëshmon qartë, rritjen e zhdërvjelltësisë së gjyqtarëve në përzgjedhjen e masave mbrojtëse dhe alternimin e tyre, me qëllim forcimin e efikasitetit të urdhrin. Fillimisht, kur nisi zbatimi i këtij ligji, vendimet e para për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes përmbanin kryesisht, alternimin e masave a dhe b, të parashikuara nga neni 10, të cilat parashikojnë vetëm urdhërimin e të paditurit të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje¹⁰. Por, gjatë viteve 2009-2010, vërejmë se në vendimet e saj, gjykata e Tiranës ka urdhëruar një sërë masash të alternuara në mënyrë logjike, për mbrojtjen e bashkëshortit/es e të fëmijëve, përfshirë edhe masat për largimin nga shtëpia, e njerit prej bashkëshortëve.

Përzgjedhja e masave mbrojtëse dhe alternimi i tyre në mënyrën më të dobishme për mbrojtjen nga dhuna, është një fakultet i Gjyqtarit, pavarësisht se paditësi/ja mund të kenë kërkuar konkretisht masat në padinë përkatëse. Prandaj,

¹⁰ Shih: Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, (periudha e monitorimit: 01.06.2007-31.04.2008, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2008.

kur konstatoam gjatë monitorimit, se gjyqtari ka dhënë në urdhrin e mbrojtjes edhe masa të tjera për të alternuar masat e kërkuara nga viktimat¹¹, menduam se, nuk jemi aspak përpara një shkeljeje të kodit të Procedurës Civile, për shkak të shtimit të objektit të padisë. ***Në rastin e padisë për lëshimin e UM/UMM-së, duhet bërë mirë dallimi midis objektit të kërkesë-padisë dhe masave mbrojtëse të kërkuara.*** Ne mendojmë se objekti i padisë në këto raste përfshin kërkesën për UM (neni 16 i ligjit), ose për UMM (neni 18 i ligjit), ose për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes (neni 22 i ligjit). Masat mbrojtëse të kërkuara në padi duhet të trajtohen nga gjykata si një opinion i kërkuarit dhe jo si objekt i kërkesë-padisë, me qëllim që gjyqtari i çështjes të ketë lirinë e nevojshme për të përzgjedhur e alternuar masat më efikase për mbrojtjen e viktimave, duke marrë edhe masa të tjera veç atyre të parashtruara nga kërkuarja/ja.

Në rast se nëpërmjet kërkesës për urdhër mbrojtje kërkohet edhe mbrojtja e fëmijëve, gjykata duhet të tregojë një kujdes të veçantë në përzgjedhjen e masave mbrojtëse dhe alternativimin e tyre me qëllim mbrojtjen efektive të fëmijëve nga dhuna. Në disa raste gjykata ka vendosur të përfshijë në vendimin e lëshimit të Urdhrin të Mbrojtjes nga masat urgjente të nenit 10 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, masën që detyron dhunuesin të qëndrojë larg fëmijëve në një distancë prej 500 m dhe ky urdhër ka efekt për një afat një vjeçar. Mendojmë se kjo masë duhet alternuar nga gjykata dhe shoqëruar me masa të tjera të domosdoshme për mbrojtjen e fëmijëve si, ndalimi ose kufizimi i takimit të dhunuesit me fëmijët, ose duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohëshme mbi fëmijët.

4. Procedurat gjyqësore për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes.

Duke marrë në konsideratë specifikën që paraqesin këto procedura, të cilat dallohen qartë nga procedurat e përgjithshme, të parashikuara nga kodi i Procedurës Civile, dëshirojmë të ndalemi në disa çështje që lidhen me procesin e të provuarit (neni 15 i ligjit). Duke interpretuar gramatikisht nenin 15 të ligjit, arrijmë në konkluzionin se paraqitja e provave shkresore gjatë procesit gjyqësor për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, nuk është një detyrim ligjor, por një mundësi e mirë për të bindur gjyqtarin. Është karakteristikë se në këtë procedurë, parashikohet që gjyqtari mund të lëshojë me vendim urdhrin e mbrojtjes, duke u bazuar në përshkrimin e rrethanave, fakteve dhe në bindjen e vet, edhe nëse nuk disponon prova shkresore të parashikuara nga ky ligj (neni 15.3 i ligjit). Por, nga monitorimi i të gjitha vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë, u konstatua se gjykata ka krijuar tashmë praktikën e gjykimit mbi bazën e provave shkresore dhe nuk e ka zbatuar në asnjë rast mundësinë ligjore për të dhënë vendim vetëm mbi bazën e bindjes së brendshme të gjyqtarit. Të dhëna në lidhje me provat në të cilat është mbështetur gjykata për dhënien e vendimit paraqiten në tabelën në vijim për 128 vendime (për të cilat gjykata ka vendosur Pranim/Pranim të Pjesshëm/Refuzim/Anullim/Rrëzim)

Ku është bazuar Gjykata në dhënien e vendimit		
	Numri i vendimeve	Në %
Bindje e brendshme/Ligj/ Prova shkresore të adm. gjatë gjykimit	44	34.37 %
Bindje e brendshme/Ligj	44	34.37 %
Bindje e brendshme/Ligj/Dëshmi me dëshmitarë	13	10.15 %
Bindje e brendshme/Ligj/Akt mjeko-ligjor	11	8.59 %
Bindje e brendshme/Ligj/Proces-verbal, deklarata,	9	7.03 %
Bindje e brendshme/Ligj/Raport i vlerësimit psikologjik	1	0.78 %

¹¹ Vendim nr. 8696, dt.27.10.2009, i Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë.

Bindje e brendshme/Ligj/ Rrethana/ Fakte/ Akt mjeko-ligjor/ Proçes-verbal, deklarata policie	6	4.68 %
Totali (Pranim/Pjesërisht/ Refuzim/Anullim/ Rrëzim)	128	100 %

Tabela nr.3

Madje, në disa raste, gjykata e ka bazuar vendimin e saj për rrëzimin e kërkesës për UM/UMM, në mosparaqitjen e asnjë prove shkresore nga ana e paditësit/ses, për të provuar pretendimet gjatë gjykimit. Ne mendojmë se mosparaqitja e provave shkresore gjatë këtij gjykimi, në vetvete nuk përbën shkak për rrëzimin e kërkesës.

Në këtë kuadër, një vëmendje më të madhe meriton aplikimi nga gjykata i masës mbrojtëse, e cila parashikon largimin menjëherë të dhunuesit/es nga banesa për një afat kohor të caktuar (neni 10, pika c). Shpesh gjyqtarët tregohen skeptikë për zbatimin e kësaj mase, për shkak të pamundësisë së tyre për të detyruar dhunuesin/en të vendoset në strehime të përkohëshme dhe programe rehabilitimi. Por, ne mendojmë se ata gabojnë kur përpiqen të bazojnë rrëzimin e një mase të tillë, për shkak të mungesës së dokumentit të pronësisë së banesës. Masat kundër dhunës janë masa urgjente dhe të përkohëshme, që vendosen për një afat të caktuar për mbrojtjen nga dhuna dhe parandalimin e saj. Gjyqtari mund të kërkojë shpjegime dhe prova që lidhen vetëm me dhunën e ushtruar dhe nuk është aspak nevoja që, gjatë këtij procesi të provojë edhe ekzistencën e pronësisë mbi banesën. Për më tepër fati i këtyre gjykimeve nuk mund të përcaktohet nga fakti nëse shtëpia është një pronë e regjistruar, apo një pronë e ndërtuar pa leje. Këto çështje nuk zgjidhen përmes gjykimeve për lëshimin e urdhrave mbrojtës. Rezultojnë disa raste kur gjykata ka kërkuar certifikatën e pronësisë, në rastet kur viktime ka kërkuar largimin e dhunuesit nga banesa¹². Ajo ka rrëzuar kërkesën e paditëses për largimin e paditësit nga banesa për shkak se paditësja nuk provoi me prova shkresore se disponon një banesë të sajën, edhe pse gjykata i dha kohë për ta provuar këtë fakt.

5. Shpejtësia e gjykimit. Një nga veçoritë themelore të këtij procesi është shpejtësia e gjykimit. Kështu, për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes gjykata vendos brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës, kurse për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes gjykata vendos brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Por, nga monitorimi, janë konstatuar raste të zgjatura përtej afateve të gjykimit të parashikuara në ligj, madje, janë konstatuar procese që kanë vazhduar nga tre deri në katër muaj¹³. Në 7 vendime nga vendimet objekt monitorimi rezultojnë të dhëna mbi disponimin e kërkesë padisë përtej afateve procedurale. Vonesat janë shkaktuar veçanërisht si pasojë e konfondimit të procedurave gjyqësore të parashikuara nga ligji kundër dhunës, me procedurat gjyqësore të parashikuara nga kodi i Procedurës Civile. Kështu, p.sh., u evidentuan disa raste kur gjykata ka vendosur njoftimin me shpallje në bazë të nenit 133 të kodit të Procedurës Civile, gjë që ka sjellë vonesa të konsiderueshme në gjykimin e çështjes. Në raste të tjera, gjykata ka shtyrë seancat gjyqësore, për arsye të ndryshme, sidomos për mosnjoftimin e të paditurit, ose për t'i lënë kohë paditëses që të paraqesë prova shkresore.

Në lidhje me sa më sipër, dëshirojmë të nënvizojmë se **shpejtësia dhe respektimi i afateve, përbën një element thelbësor të gjykimit për urdhrat e mbrojtjes, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e kuptimit të tij**. Veçanërisht shtyrja e seancës gjyqësore për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes është krejt e panevojshme, pasi gjyqtari mund të vendosë mbi bazën e rrëfimit të paditësit/es, meqënëse vërtetimi i urdhrat të mbrojtjes do të zhvillohet medoemos brenda 20 ditëve nga lëshimi i UMM-së. Gjithashtu, në të gjitha rastet e lëshimit të UM dhe UMM-se, ka vend për gjykime me një seancë të vetme dhe nuk ka kuptim gjykimi me shumë seanca, gjë që nuk do të realizonte edhe qëllimin e ligjit.

¹² Vendim: 2565, dt.30.03.2010, i Gj. së shkallës I-rë, Tiranë

¹³ Vendimi nr. 7465, dt. 23.09.2009, i Gjyk.së Shk.I-rë, Tiranë

6. Të drejtat e viktimës së dhunës në familje gjatë procesit gjyqësor civil. Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është i pari ligj në fushën civile që ka parashikuar detyrimin shtetëror për të siguruar përfaqësimin ligjor falas, për viktimat e dhunës. Megjithatë, nga dita e hyrjes në fuqi e ligjit, deri më sot, nuk kemi një listë të avokatëve që do të ofrojnë këtë ndihmë. Kjo ka sjellë mungesën e përfaqësimit me avokat të viktimave gjatë procesit gjyqësor. Vetëm në 32 raste nga çështjet objekt monitorimi, rezulton mbrojtja me avokatë e kërkuesit/es, por nuk është e qartë nëse këta janë avokatë privatë, kryesisht, ose të shërbimeve që japin ndihmë ligjore falas. Statistikat në këtë drejtim, janë shumë të nevojshme, prandaj është e domosdoshme që gjyqtari i çështjes të pasqyrojë shprehimisht në vendim përfaqësimin e viktimës nga avokati, pasi nga disa të dhëna rezultojnë që mbrojtja nuk pasqyrohet fare në vendimin përfundimtar të gjykatës.

Në raste të rralla, ka qenë vullneti i vetë gjykatës për të thirrur në përfaqësim avokatë nga lista e avokatëve kryesisht në procesin penal, gjë që na duket shumë e arsyeshme për një respektim drejtpërdrejt të dispozitave të ligjit. Aktualisht, organizimi i kësaj ndihme duhet të realizohet në zbatim të ligjit “Për ndihmën juridike”¹⁴, i cili edhe pse ka hyrë në fuqi nga prilli i vitit 2009, ende nuk ka filluar të gjejë zbatim. **Mungesa e ndihmës ligjore falas, mendojmë se përbën një nga barrierat kryesore për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor efektiv për viktimat e dhunës, të cilat lihen vetëm dhe pa mbrojtje ligjore.** Ne kemi mendimin se mbrojtja me avokat falas do të ndikojë ndjeshëm në uljen e rasteve të pushimit të gjykimit, në marrjen e masave efektive, si dhe në respektimin e afateve të shpejta të këtij gjykimi.

Aktualisht, Organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas për viktimat kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për periudhën objekt monitorimi ka mbështetur 67 viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Janë përgatitur 27 akte për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe 17 viktima janë përfaqësuar në gjykatë. 40 nga viktimat e dhunës kanë përfituar këshillime ligjore.

Gjykata ka vlerësuar me seriozitet rrezikshmërinë me të cilën përballlet viktima duke parashikuar kohëzgjatje të arsyeshme të UM në përputhje me rrezikshmërinë. Tabela në vijim na jep të dhëna mbi kohëzgjatjen e urdhrave të mbrojtjes për periudhën objekt monitorimi, për 111 raste për të cilat Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, ka vendosur pranimin e kërkesës ose pranimin e pjesshëm të saj.

Kohëzgjatja e UM		
	Numri	Në %
3 muaj	2	1.8 %
4 muaj	4	3.6 %
5 muaj	3	2.7 %
6 muaj	13	11.71 %
7 muaj	1	0.9 %
8 muaj	1	0.9 %
9 muaj	2	1.8 %
10 muaj	2	1.8 %
12 muaj	64	57.65 %
Pranim kerkese nga gjykata pa percaktuar afatin	19	17.11 %
Totali umm & um	111	100 %

Tabela nr.4

¹⁴ Ligj nr.10039, dt. 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”.

Siç rezulton nga tabela në 57.65 % të rasteve gjykata ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes me kohëzgjatjen maksimale të parashikuar në ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, 1 vit.

7. Çështje të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes. Zbatimi i urdhrave të mbrojtjes mbetet një nga çështjet themelore të mbarëvajtjes së procesit gjyqësor. Lëshimi i UM-së dhe UMM-së nga gjykata përfaqëson një moment shumë të rëndësishëm, por zbatimi i tyre mbetet çështja kyç për efektivitetin e zbatimit të ligjit. Natyrisht, një rol të rëndësishëm në këtë aspekt luajnë organet shtetërore të ngarkuara me ndjekjen e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, konkretisht: zyrat përkatëse të përmbarrimit, komisariati i policisë të rajonit përkatës, si dhe zyrat e shërbimeve sociale pranë organeve përkatëse vendore. Megjithatë, këtu dëshiroj të ndalem në disa aspekte të rolit të gjykatës civile për një zbatim të mirë të urdhrave të mbrojtjes. Për këtë qëllim gjykata duhet të tregojë vëmendje që të bëjë të qartë në vendimin për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes se, ky urdhër, që në momentin që shpallet ose u njoftohet palëve, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë nga zyra e përmbarrimit (neni 23 i ligjit). Mendojmë se urdhri i ekzekutimit lëshohet në pjesën e dispozitivit të vendimit për lëshimin e UMM-së dhe nuk është fjala për ndonjë proces ose vendim tjetër në këtë kuadër. Gjithashtu, vendimi gjyqësor që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titullin ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përmbarruesit, zyrat e komisariateve të policisë, si dhe njësitë e qeverisjes vendore (neni 23 i ligjit). Kështu, nuk mund të justifikohen pretendimet e Zyrës së Përmbarrimit, Tirane, e cila në disa raste i ka kërkuar paditësit edhe marrjen e urdhrin të ekzekutimit nga gjykata, pasi kjo e fundit, ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes¹⁵.

Në këto kushte, *gjykata në dispozitivin e vendimit duhet të shprehet qartë duke urdhëruar institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes*. E theksojmë këtë fakt, sepse kemi evidentuar vendime që shprehen për dërgimin e urdhrave mbrojtës në këto subjekte “për komunikim”¹⁶. Është e nevojshme që gjuha e vendimit të jetë e qartë në urdhërimin e ekzekutimit të urdhrin, sipas dispozitivit të lëshuar në vendimin e gjykatës.

Në 5 vendime të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes, objekt monitorimi, vendimi i gjykatës nuk referohet në institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Gjithashtu, kujdes duhet të bëhet për pajisjen e palëve me kopjet e vendimit për UM ose UMM. Ai përbën titull ekzekutiv, pavarësisht nëse është ankimuar ose jo nga njëra prej palëve. Në këto kushte, administrata e gjykatës nuk mund të pengojë pajisjen e palëve me kopjet e vendimit, me arsyetimin se vendimi është ankimuar.

8. Profili social i viktimës dhe dhunuesit.

Në përqindjen më të lartë të rasteve, në 20.93% të tyre, rezulton se paditësja/i është me arsim të mesëm; në 19.21 % të rasteve paditësja/i është me arsim tetë vjeçar dhe në 8.37 % të rasteve paditësja/i është me arsim të lartë. Vetëm në 0,73 % të rasteve, viktimë është pa arsim. Kështu, nga vendimet e monitoruara rezulton se në një përqindje të lartë të rasteve 48.27 % për paditësen/in dhe 62.56% për të paditurin/en, në vendimet e Gjykatës nuk gjejmë të dhëna mbi arsimin e palëve ndërgjyqëse. Pra, konkludojmë se në përgjithësi, e dhunuara/paditëse, është një grua e arsimuar.

Një paditëse e arsimuar do të thotë një paditëse që e denoncon dhunën, që është e informuar për mjetet ligjore që ajo mund të përdorë për mbrojtje, që është e informuar mbi shërbimet ekzistuese, që është e ndërgjegjësuar se dhuna dhe familja e shëndoshë nuk kanë asgjë të përbashkët me njëra tjetrën.

Përqindja prej 8.37 % e paditëseve/paditësave me arsim të lartë tregon se dhuna në marrëdhëniet familjare është prezente, pavarësisht nga niveli arsimor.

¹⁵ Është kërkuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë, nr. 3618, dt. 03.05.2010

¹⁶ Vendim nr. 1089, dt. 17.02.2010, i Gjyk. Së shkallës së I-rë, Tiranë

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare me më pak se tetë klasë, zënë përqindje të ulët. Kështu vetëm në 2.46% të rasteve viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare ka kryer 4 klasë studime. Ky është tregues i qartë i faktit se një grua e paarsimuar ka më pak mundësi punësimi dhe demonstroi një varësi ekonomike nga burri dhe anëtarët e tjerë të familjes. Kjo varësi e bën atë vulnerabël dhe e bën të heshtë dhe të denoncojë në përqindje më të ulëta dhunën me të cilën ajo përballet në marrëdhëniet familjare. Nga rezultatet e monitorimit rezulton se në 17.98 % të rasteve paditësi/ia është punëtor/punëtor.

Në përqindjen më të lartë të rasteve në 14.53 %, i padituri është me arsim 8 vjeçar dhe në 13.55 % me arsim të mesëm. Në 7.14 % të rasteve, i padituri është me arsim të lartë. Fakti që, rezulton një i/e paditur me arsim 8 vjeçar tregon mbi një element të profilit social të dhunuesit, i cili ka një ndërgjegjësim të ulët mbi faktin se familja dhe dhuna nuk kanë asgjë të përbashkët me njëra tjetrën, përballet me problematikat e punësimit, njeh pak ligjin dhe detyrimet e parashikuara në të. Kështu nëse do të referoheshim të dhënave nga monitorimi në lidhje me profesionin e palës së paditur rezulton se, në 18.72 % të rasteve i padituri është punëtor/punëtor.

Në lidhje me punësimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga monitorimi rezulton se, në 55.17 % të rasteve nuk ka të dhëna mbi faktin nëse paditësi/ia është i/e punësuar. Në 21.67 % të rasteve paditësi/ia është e punësuar dhe në 18.72 % të rasteve paditësi/ia nuk është e punësuar. (Shih tabelën nr.5) Rezulton se nga monitorimet e para ka një përgjegjshmëri më të madhe nga ana e gjykatës për të reflektuar të dhëna në lidhje me punësimin e palëve gjyqësore.

Përqindja prej 55.17 e rasteve pa të dhëna në lidhje me punësimin e palëve, ka efekt mbi gjetjet e raportit monitorues. Sidoqoftë, fakti që të punësuarit kanë përqindje më të lartë të kërkesave për urdhër mbrojtjeje mund të lidhet me pavarësinë e tyre për të përdorur mjetet ligjore. Ky grup ka ndërgjegjësim më të lartë për të denoncuar dhunën, për shkak të jetës kolektive që ata kryejnë por mund të lidhet edhe me pasigurinë e shumë të punësuarëve për të ruajtur vendin e punës dhe stresin më të madh, i cili rrit nivelin e dhunës dhe agresivitetin në sjelljet me anëtarët e familjes në marrëdhëniet familjare.

Të dhëna mbi punësimin e palëve

Punësimi				
	Paditës/e	Në %	I, e Paditur	Në %
Të punësuar	88	21.67 %	79	19.45 %
Të papunë	76	18.72%	70	17.24 %
Pensionistë	18	4.43 %	7	1.72 %
S'ka të dhëna	224	55.17 %	250	61.58 %
Totali	406	100 %	406	100 %

Tabela nr.5

Përqindja më e lartë i përket viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare me dy fëmijë. (23.39 %) (Shih tabelën nr.6) Rezultojnë në 13.54 % të rasteve viktimat me një fëmijë; në 12.80 % të rasteve viktimat me tre fëmijë; në 2.70 % të rasteve viktimat me katër fëmijë; në 0.25 % të rasteve viktimat me pesë fëmijë; në 0.49 % të rasteve

viktima me 6 fëmijë dhe në 0.25 % të rasteve viktima me shtatë fëmijë. (Shih tabelën nr.6) Numri i rasteve me një fëmijë përbën 13.54 % të rasteve, pra përbën një përqindje të konsiderueshme.

Përqindja më e lartë e rasteve me dy dhe një fëmijë tregon se vitet e para të martesës shoqërohen edhe me kundërshtinë midis idealeve të pritshmeve tek bashkëshorti/ ja e ardhshme dhe realeve që ata ofrojnë. Kjo kundërshti krijon mosmarrëveshje midis bashkëshortëve, mosmarrëveshje që mund të shoqërohen me forma të ndryshme dhune.

	Paditës/e	Në %
Pa fëmijë	10	2.46 %
1 fëmijë	55	13.54 %
2 fëmijë	95	23.39 %
3 fëmijë	52	12.80 %
4 fëmijë	11	2.70 %
5 fëmijë	1	0.25 %
6 fëmijë	2	0.49 %
7 fëmijë	1	0.25 %
9 fëmijë	-	-
10 fëmijë	-	-
Kanë fëmijë (Nuk jepet nr.)	7	1.72 %
S'ka të dhëna	172	42.36 %
Totali	406	100 %

Tabela nr.6

Grupmosha e palës paditëse që përballet më shumë me dhunën në marrëdhëniet familjare është grupmosha 31-40 vjeç. Kjo grupmoshë zë 28.81 % të rasteve. Kurse, 25.86 % e zë grupmosha 18-30 vjeç dhe 20.44 % e zë grupmosha 41-50 vjeç. (Shih tabelën nr.7)

Ajo që rezulton nga tabela është se, me rritjen e grupmoshës, bie niveli i dhunës.

Kështu janë 11.08 % paditësat/et që i përkasin grupmoshës 51-60 vjeç; janë 2.95 % paditësat/et që i përkasin grupmoshës 61-70 vjeç; janë 3.45 % paditësat/et që i përkasin grupmoshës 71-80 vjeç dhe 0.98 % i përkasin grupmoshës 81-90 vjeç.

Ndonëse në përqindje me të ulëta, në këto grupmosha këto të dhëna flasin se sa prezente është në shoqërinë tonë dhuna ndaj të moshuarve, në formë të drejtpërdrejtë ose në formë të asistuar.

Të dhëna në lidhje me grupmoshën e palëve

Moshë				
	Paditës, e	Në %	I, e Paditur	Në %
Nën 18 vjeç	5	1.23 %	2	0.49 %
18-30 vjeç	105	25.86 %	35	8.62 %
31-40 vjeç	117	28.81 %	120	29.56 %
41-50 vjeç	83	20.44 %	109	23.85 %
51-60 vjeç	45	11.08 %	51	12.56 %
61-70 vjeç	12	2.95 %	11	2.71 %
71-80 vjeç	14	3.45 %	6	1.48 %
81-90 vjeç	4	0.98 %	-	-
S'ka të dhëna	21	5.17 %	72	17.73 %
Totali	406	100 %	406	100 %

Tabela nr.7

Nga monitorimi rezulton se në 66.99 % të rasteve pala paditëse është me banim në qytet dhe në 22.41 % të rasteve pala paditëse është me banim në fshat. Në 10.59 % të rasteve nuk ka të dhëna në lidhje me vendbanimin e palës paditëse.

Format e ushtrimit të dhunës nga pjesëtarët e familjes. Veçoritë e mbrojtjes së të miturve. Në përgjithësi, vendimet japin të dhëna mbi format e ushtrimit të dhunës. Madje, disa prej tyre, parashtrajnë edhe shkaqet e tyre. Megjithatë, ka mjaft vendime në të cilat nuk është përshkruar mirë situata e dhunës. Në ndonjë rast, gjatë arsyetimit të vendimit, gjyqtari nuk e parashtron këtë situatë, duke theksuar se u është referuar episodeve të shpjeguara në komisaratin e policisë¹⁷. Ne mendojmë se paraqitja e formave dhe episodeve të dhunës, është një pikë kyçe për arsyetimin e vendimit për lëshimin e urdhrave mbrojtës, për drejtësinë e marrjes së këtij vendimi, si dhe për ta bazuar në fakte të vërteta.

Nga vendimet, është evidentuar se, dhuna fizike është e pranishme në një përqindje të lartë të rasteve. Por, shpesh ajo ushtrohet e kombinuar me dhunën psikologjike. Kështu, në 80.4 % të rasteve rezulton të jetë ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike e kombinuar. Përveç tyre, janë të pranishme gjithashtu, edhe dhuna ekonomike, dhuna e asistuar, si dhe dhuna e kombinuar e dy ose më shumë formave të mësipërme. Të dhëna në lidhje me përhapjen e formave të ndryshme të dhunës në çështjet e gjykuara (për të cilat është vendosur nga gjykata Pranim, Pranim i pjesshëm, Refuzim, Anullim ose Rrëzim kërkesë) paraqiten në tabelën në vijim:

Format e Dhunës

¹⁷ Vendimi nr. 1244, dt. 22.02.2010, i Gjykatës së Shkallës së I-rë, Tiranë.

	Numri	Në %
Dhunë Fizike/ Psikologjike	103	80.4 %
Dhunë Psikologjike	22	17.18 %
Dhunë Psiko-ekonomike	3	2.34 %
Totali i çeshtjeve të gjykuara Pranim/ Pjesërisht/ Rrefuzim/Anullim/ Rrëzim)	128	100 %

Tabela nr.8

Madje, në këtë monitorim, në dallim nga monitorimet e viteve të mëparshme, ka rezultuar shqetësues edhe ushtrimi i dhunës përmes ndjekjes dhe gjurmimit të viktimës nga dhunuesi, dhunë e cila, është një kombinim i dhunës fizike me atë psikologjike, që sjell frikë e pasiguri tek viktimat. Kjo formë është evidentuar nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në 5 vendime gjyqësore gjatë periudhës objekt monitorimi¹⁸. Kjo tendencë në format e dhunës shtron nevojën e miratimit të ligjeve specifike kundrejt ndjekjes, gjurmimit, detyrim që buron nga standardet ndërkombëtare. (Rezoluta 1997).

Disa nga format e dhunës të identifikuar në vendimet objekt monitorimi janë: goditje me grushta në fytyrë dhe në pjesë të tjera të trupit; fyerje “kafshë”, kërcënime nëpërmjet telefonit të viktimës dhe anëtarëve të familjes së origjinës së viktimës; Thyerje e derës së dhomës; kërcënime me fjalët “do të vras, do të zhduk”, goditje në gjendje të dehur, kërcënime si: “nuk do ti takosh më fëmijët”, “fëmijët nuk të duan”, kërcënime të fëmijëve me fjalët “nuk do ta takoni nënën, nuk do ti flisni në telefon, nuk duhet të përgjigjeni kur u merr ajo dhe fjalë të tjera fyese në adresë të viktimës”; shtrëngim për largim nga banesa; mos dhënia e kontributit për mirëritjen e fëmijëve; vendosja e duarve në fytyrë e bashkëshortes duke e kërcënuar me jetë; harxhim i të ardhurave të fituara nga puna në lojërat e fatit; kërcënim se do ta nxjerrë djalin jashtë Shqipërisë që viktima të mos e shohë më; dëmtime trupore që kanë rezultuar në humbje të aftësisë së përkohshme për punë mbi 9 ditë; shqetësim të ish bashkëshortes në vendin e punës pas zgjidhjes së martesës; marrja e fëmijëve pa leje dhe mbajtja e tyre përtej vendimit të dhënë nga gjykata; kërcënime se “do shes shtëpinë e përbashkët”; ushtrim dhune nga bashkëshorti çdo ditë; dhunë ndaj të moshuarëve në formën kërcënim nga nusja se do i mbyllë në psikiatri, gjuajtje, thyerje të gishtit të këmbës; përplasje e viktimës nga bashkëshorti duke e lënë pa ndjenja; dhunë psikologjike ndaj të moshuarës nga djali dhe nusja e djalit, marrja e çelësave të shtëpisë, nxjerrja e pengesave të moshuarës kur kalonte në mënyrë që të rrëzohej në shtëpi; ndjekja dhe gjurmimi i ish bashkëshortes nga puna për në shtëpi, në shkollën ku ajo studion, në shtëpinë e prindërve të saj që nga momenti i zgjidhjes së martesës; veprime të pakontrolluara të kryera nën efektin e drogës ndaj familjarëve; gjendje ankthi dhe pasigurie ndaj familjarëve; goditje e bashkëjetueses shtatzanë¹; fyerje në drejtim të nderit dhe dinjitetit të bashkëshortes; thyerje dhe shkatërrim i objekteve të shtëpisë si sobë, fritezë, thekëse, karrige, moslejimi i përdorimit të ambjenteve të përbashkëta; kërcënime në shkollën e djalit; dhunë ekstreme sa lyheshin muret me gjak në prani të fëmijëve, fyerje “plehrë”, “e sëmurë mendore”, goditje me shkop; goditje me shkelma, grushta dhe sende të forta në prani të fëmijëve, kërcënime me pistoletë në kokë.

Shkaqet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Shkaqet e dhunës	Numri
Alkooli	26
Droga	1

¹⁸ Viktima A.H deklaron se i padituri ushtron dhunë psikologjike ndaj saj duke e ndjekur nga puna për në shtëpi, në shkollën ku ajo studion si dhe në shtëpinë e prindërve të saj ku ajo banon prej momentit të zgjidhjes së martesës.

Bixhozi	2
Xhelozia	3
Karakteri i dhunshëm	12
Papunësia	2
Gjendja ekonomike	6
Çështje pasurore/pronësie	30
Mosmarrëveshje/Konflikte familjare	42
Zgjidhja e martesës	12
Lidhja jashtëmartesore	8
Konflikte për kujdestarinë e fëmijëve	4
Nuk jepen të dhëna në vendim	26

Tabela nr.9

Shkaqe kryesore të dhunës në familje rezultojnë: papunësia, problemet ekonomike, xhelozia, konflikte e mosmarrëveshje pas zgjidhjes së martesës që lidhen me çështje pasurore e pronësie, si dhe me çështje të kujdesit për fëmijët dhe pagesës së detyrimit ushqimor; lidhjet jashtëmartesore, si dhe fakti që dhunuesi është i dhunshëm në thelb si rezultat i rritjes në një ambient të dhunshëm familjar.

Në 26 raste dhunuesit janë përdorues të rregullt të alkolit, në 1 rast përdorues droge dhe në 2 raste shpenzojnë fitimet e tyre në lojëra fati dhe në 3 raste vuajnë nga probleme të shëndetit mendor.

Parashtrimi me qartësi i formave të dhunës dhe i shkaqeve të saj përgjatë arsytimit të vendimit, përbën një standard të rëndësishëm, jo vetëm për nevojat e arsytimit të vendimit, por edhe për përzgjedhjen e masave mbrojtëse efikase, prandaj nuk mund të anashkalohet.

Cili është personi më i dhunuar në familje?

Në 93.34 % të vendimeve të monitoruara për periudhën 01.06.2009-01.06.2010, paditëset janë gra dhe në 6.65% të rasteve paditësat janë burra (shih tabelën nr.1). Të dhënat tregojnë se gruaja vazhdon të jetë pjesëtari më i dhunuar në marrëdhëniet familjare duke demonstruar në të njëjtën kohë se dhuna ndaj grave është shprehje e pushtetit të burrave mbi to dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Lidhja midis paditësit/es dhe të paditurit/ës

Nga 406 vendimet objekt monitorimi rezulton se, në 43.34% të rasteve, dhunuesi me viktimën kanë qenë bashkëshortë; në 8.87 % të rasteve subjektet kanë qenë ish-bashkëshortë; në 6.17 % të rasteve subjektet janë prind/fëmijë; në 1.72 % të rasteve janë nuse/vjehërr dhe në 0.74 % të rasteve subjektet janë fëmijë/prindër. Ka pasur

raste të dhunës edhe midis familjarëve, si: kunata, fëmijë/prind, bashkëjetues, ish bashkëjetues dhe marrëdhënie vëllazërore.

Duket qartë se, personi më i dhunuar është bashkëshortja, i ndjekur nga ish bashkëshortja, gjetje kjo edhe e raporteve monitoruese të kryera më parë nga Qendra për Nisma ligjore Qytetare për periudhën objekt monitorimi 01.06.2007-30.04.2008 dhe 30.04.2008-01.06.2009.

Zgjidhja e martesave shoqërohet me mosmarrëveshje që lidhen me çështje pasurore e pronësie, si dhe me çështje të kujdesit për fëmijët dhe pagesës së detyrimit ushqimor. Për viktimat e dhunës në familje, shpesh zbatimi i modaliteteve të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të përcaktuara nga gjykata do të thotë një cikël i ri i abuzimit dhunues/viktimë. Problematikat sociale që shoqërojnë zgjidhjen e martesës lidhen edhe me jetesën në të njëjtën banesë të ish bashkëshortëve.

Nga 406 vendimet objekt monitorimi, rezulton se në 24 raste, palët janë në procesin e zgjidhjes së martesës dhe në 4 raste i janë drejtuar gjykatës për çështje pronësie.

Një çështje tjetër e rëndësishme është evidentuar për shkak të qëndrimeve të ndryshme që kanë mbajtur gjykatat në mbrojtjen përmes urdhrin të mbrojtjes të subjekteve që kanë qenë në lidhje dashurie ose fejeje. Në këtë rast, për shkak të mosparashikimit në mënyrë të shprehur nga ligji të këtyre kategorive, kemi identifikuar për subjekte krejt të ngjashme, lëshimin e urdhrin të mbrojtjes nga Gjykata e rrethit gjyqësor, Tiranë dhe moslëshimin e këtij urdhri nga gjykata e rrethit gjyqësor, Fier¹⁹. Ne mendojmë se subjektet që janë në marrëdhënie të ngjashme afektive me ato të mbrojtura nga ligji, si bashkëjetues, ishbashkëjetues, ishbashkëshortë, duhet të interpretohen nga gjykata si subjekte që duhet të kenë një mbrojtje të barabartë. Për këtë është e nevojshme të ndërhyhet edhe në ligj, me një shtojcë që mund të parashikojë të fejuarit/ish të fejuarit dhe të dashuruarit/ish të dashuruarit, si subjekte familjare.

Dhuna ndaj fëmijëve në marrëdhëniet familjare

Por, në të dhënat mbi lidhjen viktimë/dhunues duhet të mbajmë parasysh faktin se është shumë i ulët numri i kërkesave për urdhrat e mbrojtjes në emër të fëmijëve, për dhunën e drejtpërdrejtë që ushtrohet ndaj tyre. Kemi mendimin se dhuna ndaj fëmijëve denoncohet pak. Ndërkohë, fëmijët rezultojnë të jenë personat që kanë pësuar më shumë dhunë të asistuar në raport me anëtarët madhorë të familjes. Konkretisht, nga 406 vendime gjyqësore të monitoruara, në 93.34 % të tyre, paditëset janë gra dhe, në 6.65% të rasteve, paditësit janë burra. Nga 111 çështje për të cilat Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës ose pranim të pjesshëm të kërkesës në 45.94 % të rasteve, fëmijët janë persona të tretë të dëmtuar nga dhuna.

Nga arsyetimi i vendimeve rezulton se, dhuna fizike është ushtruar edhe ndaj fëmijëve ose në prezencën e tyre, duke i bërë ata subjekte të dhunuar jo vetëm përmes dhunës së asistuar, por edhe drejtpërdrejt. Format më ekstreme të ushtruara ndaj fëmijëve janë: largim me dhunë nga shtëpia i bashkëshortes dhe fëmijëve, gjuajtje me karrige, kërcënime me fjalët “do të vras, do të zhduk”, “nuk do ti takosh më fëmijët”, “fëmijët nuk të duan”; goditje e fëmijës me çadër duke e dëmtuar në kokë, moslejimi i përdorimit të ambienteve të përbashkëta; goditje e bashkëshortes me sende të forta në prani të fëmijëve, etj.

“Studimet tregojnë se dëshmitarët fëmijë, mesatarisht, janë më agresivë dhe më të frikshëm dhe më shpesh vuajnë nga ankthi, depresioni dhe simptoma të tjera traumatike kur krahasohen me fëmijët që nuk kanë qenë dëshmitarë të abuzimit ose që nuk kanë qenë të abuzuar. Fëmijët që rriten në shtëpi të dhunshme shpesh ndjehen sikur ata janë përgjegjës për abuzimin dhe mund të ndjehen fajtor sepse mendojnë se ata e shkaktuan atë ose sepse ata janë të paafët ta ndalojnë atë. Ata jetojnë me ankthin e vazhdueshëm se një tjetër goditje do të ndodhë ose se ata do të

¹⁹ Gjykata e Shkallës së I-rë Tiranë ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nr.5917, datë 15.07.2010, për çështjen me palë A.B dhe A.Gj. Gjykata e Shkallës së I-rë Fier ka rrëzuar kërkesën për urdhër mbrojtje për çështjen me palë E.S dhe E.T.

braktisen. Ata mund të ndjehen fajtorë ose konfuzë në lidhje me dashurinë për prindin abuzues ose në lidhje me trajtimin si të çmendur të viktimës. Fëmijët mund të jenë në rrezik të madh nga alkoli ose abuzimi me drogën, të përjetojnë probleme të njohjes ose sëmundje të lidhura me stresin (dhimbje koke, etj) dhe mund të kenë vështirësi në shkollë²⁰.

Kështu në vendimin nr.6965, dt.13.08.2009, me objekt lëshimin e UM, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pranon se pasojë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë rezultatet e dobëta të të miturit në mësim.

Pasojat e dhunës në marrëdhëniet familjare mbi fëmijët, si në rastet kur fëmijët dhunohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ashtu edhe kur ata asistojnë në skena dhune është e nevojshme të njihen dhe vlerësohen dhe të jenë në qendër të vëmendjes së profesionistëve me qëllim adresimin e tyre në mënyrë profesionale.

Këto raste na bëjnë të mendojmë se duhet të forcohet rrethi i subjekteve që mund të kërkojnë UM/UMM në favor të një të mituri. Deri tani, kërkesat e dërguara në gjykatë nga policia, paraqiten në emër të nënës, e cila ka kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët e saj. Ndërkohë, konstatojmë se ende nuk po gjen zbatim padia publike e vendosur në ligj, e cila presupozon që, në emër të viktimës, kërkesa të paraqitet nga policia ose prokuroria. Kjo duhet të zbatohet veçanërisht në emër të një të mituri. Veçoria e padisë publike në emër të viktimës qëndron në faktin se, pasi është paraqitur nga policia ose prokuroria, tërheqja e viktimës ose e kujdestarit të fëmijës nga padia, nuk passjell pushimin e gjykimit. Kështu, do të sigurohej një mbrojtje më e sigurtë për fëmijët, e cila nuk do të varej më nga vullneti i nënës së tyre për t'i mbrojtur përmes urdhrave të mbrojtjes. Në dy raste gjatë periudhës objekt monitorimi, rezultoi se viktima është tërhequr nga procesi për të vënë në mbrojtje edhe fëmijët, gjë që është pranuar nga gjykata²¹. Në ligjin e ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”, është synuar forcimi i subjekteve që mund të kërkojnë urdhër mbrojtjeje për fëmijët, duke shtuar Policinë, Prokurorinë, si dhe personat ligjërisht përgjegjës²².

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” u njeh të drejtën Zyrrave të Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave dhe qendrave dhe shërbimeve për rehabilitimin e viktimave të dhunës të paraqesin kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe urdhër mbrojtjeje për të mitur (neni 13 i ligjit), por nuk na rezultoi asnjë rast që këto subjekte të kenë ushtruar këtë të drejtë duke treguar ngurrim në zbatimin e ligjit.

Në përfundim do të theksonim faktin se, **ka nevojë të forcohet mbrojtja e fëmijëve përmes denoncimit të rasteve të dhunës ndaj tyre dhe urdhrave civilë të mbrojtjes, veçanërisht përmes forcimit të padisë publike të policisë dhe prokurorit, por edhe në sja të përfaqësimit të qendrave dhe shërbimeve, të afërmeve, personave ligjërisht përgjegjës (shkolla), etj.**

Persona të tretë të dëmtuar nga ushtrimi i dhunës në marrëdhëniet familjare janë edhe bashkëshortja në 3.6 %; prindërit në 1.8%, të afërmit më 3.6 %, të 111 çështjeve të gjykuara nga gjykata, për të cilat është vendosur pranimit kërkesë ose pranimit i pjesshëm i kërkesës.

²⁰ www.stopvaw.org/Effects_of_Domestic_Violence_on_Children.html

²¹ Vendimi nr. 8696, dt. 27.10.2009, i Gjykatës së shkallës së I-rë, Tiranë

²² Ligj Nr. 10 329, datë 30.9.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”. neni 5.

Viktimat e dhunës në familje kanë denoncuar dhunën drejtpërdrejtë duke u paraqitur në organet e policisë ose gjykatës.

Komuniteti mund të luajë një rol aktiv në denoncimin e dhunës në familje në organet përkatëse. Nga monitorimi rezulton se komuniteti vazhdon të jetë pasiv në lidhje me denoncimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare duke përfunduar karakterizimin historik të dhunës, se ajo është një çështje private që u përket vetëm pjesëtarëve të familjes dhe duhet të mbetet brenda mureve të shtëpisë. Kështu në 125 raste nga vendimet objekt monitorimi viktimat ka denoncuar dhunën me të cilën është përballur në organet përkatëse dhe në asnjë rast nuk gjejmë të dhëna mbi denoncimin e dhunës nga komuniteti.

9. Sugjerime. Duke vështruar me kujdes disa nga përfundimet në të cilat kemi arritur gjatë procesit të monitorimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së I-rë, Tiranë, mund të evidentojmë edhe disa sugjerime, me të cilat synojmë të japim ndihmesën tonë në rritjen e efektivitetit të urdhrave civilë të mbrojtjes, për të parandaluar dhunën në familje.

Së pari, në lidhje me rolin e pushtetit gjyqësor, është e nevojshme që gjyqtari në procesin civil, të identifikojë situatat e dhunës, format e saj, si dhe shkaqet për të cilat ajo ka ardhur. Këto duhet të pasqyrohen në pjesën arsyetuese të vendimit, si një premisë e mirë për dhënien e një vendimi gjyqësor të drejtë dhe efikas. Këtij qëllimi do t'i shërbente edhe parashtrimi i pretendimeve të të paditurit/ës, të cilat shpesh nuk pasqyrohen në vendime.

Zgjidhja me pajtim e konfliktit të dhunës në familje, nuk mund të shërbejë si parim, gjatë zbatimit të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Në këtë rast nuk jemi përpara zbatimit të kodit të Procedurës Civile, për të kryer përpjekjet për pajtimin e palëve në seancën gjyqësore.

Gjykata çmon masat më efikase mbrojtëse të UM-së dhe UMM-së, si dhe alternimin më të mirë të tyre. Masat mbrojtëse të kërkuara në padi duhet të trajtohen nga gjykata si një opinion i kërkuarit dhe jo si objekt i kërkesëpadsisë, me qëllim që gjyqtari i çështjes të ketë lirinë e nevojshme për të përzgjedhur e alternuar masat më efektive për mbrojtjen e viktimave.

Një vëmendje e veçantë ka nevojë t'i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në familje. Gjyqtari nuk ka pse të ngurrojë të përfshijë në urdhrin e mbrojtjes edhe fëmijët që kanë pësuar dhunë të asistuar. Lind nevoja të forcohet padia publike dhe kërkesat për urdhër mbrojtjeje për fëmijën, në rastet e ushtrimit të dhunës së drejtpërdrejtë nga cilido anëtar i familjes. Për këtë mendojmë se krijon mundësi më të mëdha Ligji nr.10329, datë 30.09.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, i cili parashikon se, policia prokuroria janë subjekte që legjitimohen të paraqesin urdhër mbrojtjeje për të mitur.

Vlerësimi i provave gjatë gjykimit për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes është një fakultet i gjyqtarit, megjithatë, mosparaqitja e provave shkresore gjatë këtij gjykimi, në vetvete, nuk duhet trajtuar si shkak për rrëzimin e kërkesës. Ligji njuh mundësinë e lëshimit të urdhrin mbi bazën e përshkrimit të rrethanave dhe bindjes së vetë gjyqtarit.

Vendimi i gjyqtarit civil për të vendosur përfaqësimin e viktimave të dhunës gjatë procesit gjyqësor për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, nga avokatë kryesisht, falas, përbën një zbatim efikas të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, sa kohë që, 3 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit, nuk kemi asnjë akt nënligjor, ose listë të avokatëve kryesisht të trajnuar për përfaqësimin e viktimave të dhunës.

Gjatë vërtetimit të urdhrin të mbrojtjes, gjykata civile nuk mund të vendosë për lëshimin ose jo të urdhrin të mbrojtjes, duke u bazuar vetëm në situatën e krijuar pasi është lëshuar urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes. Nuk është ky qëllimi i vërtetë i ligjit. Gjykata nuk mund të vendosë vetëm mbi faktin nëse i padituri ka shkelur ose jo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, por mbi bazën e të gjithë historisë së rrethanave të shqyrtuara gjatë gjykimit të çështjes.

Së dyti, në lidhje me rolin e prokurorisë,

Të rritet roli i prokurorit në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Është e nevojshme që ai të drejtojë kërkesa në emër të personave të dhunuar, ose më mirë në emër të vetë prokurorisë. Kjo theksohet sidomos në rastet e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna.

Së treti, Në lidhje me rolin e organeve vendore dhe shërbimit social,

Zyrat e Shërbimeve Sociale pranë bashkive dhe komunave dhe qendrat e shërbimet për rehabilitimin e viktimave të dhunës të përmbushin më mirë përgjegjësitë me të cilat i ngarkon ligji që lidhen jo vetëm më informimin, mbështetjen dhe referimin e rasteve në aktorë të tjerë por edhe me paraqitjen e kërkesave për urdhra mbrojtje siç parashikohet në ligj dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës për lëshimin e urdhrave të Mbrojtjes.

Rekomandohet gjithashtu të parashikohen vizitat e mbikëqyrura, të cilat janë të domosdoshme në rastet kur është e provuar dhuna e ushtruar nga prindi mbi fëmijët në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo. Rekomandohet që në rastet kur prindi dhunues ka të drejtën e takimit, vizitës të shoqërohet vendimi me një plan sigurie që do të ofronte mbrojtje për viktimën dhe fëmijët dhe nuk do ti përballte ato me një dhunë edhe më ekstreme.

Rekomandohet përmirësimi i organizimit të psikologëve dhe punonjësve socialë, të zgjidhet çështja e statusit të tyre me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre, ofrimin e standardeve dhe kontrollin e profesionalizmit gjatë ushtrimit të detyrës.

Së katërti, për organet qendrore të rrejtit kundër dhunës, (sidomos Ministria e Punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta dhe Ministria e Drejtësisë)

Rekomandohet të merren të gjitha masat me qëllim që të zbatohet ligji nr.10329, datë 30.09.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Rekomandohet të nxitohet për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore, veçanërisht të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

Rekomandohet të merren të gjitha masat e nevojshme për organizimin e shërbimit ligjor falas, të kualifikuar për viktimat e dhunës në familje.

Rekomandohen politika dhe shërbime efektive për personat me probleme të përdorimit të drogës dhe alkolit.

Gjithashtu, rekomandohen politika dhe ligje efektive për personat me probleme të shëndetit mendor. Trajtimi i kujdesshëm i këtyre personave dhe marrja e masave për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, kur ajo ushtrohet nga persona me probleme të shëndetit mendor janë nevojë imediate.

Inkurajohen studime mbi koston e dhunës në familje në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë, kur ajo kryhet nga persona që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor.

Nw bashkëpunim me shoqërinë civile, të ndërmarrin nisma ligjore për të forcuar mekanizmin institucional dhe masat për dënimin e autorëve që nuk i binden urdhrat të mbrojtjes dhe e shkelin atë.

Së pesti, në lidhje me rolin e policisë,

Të rritet roli dhe efektiviteti i organeve të specializuara të policisë për monitorimin e respektimit të urdhrave të mbrojtjes, si dhe zbatimin e sanksioneve të ligjit për të gjithë ata që thyejnë urdhrat e mbrojtjes të lëshuar nga gjykata.

Të rritet bashkëpunimi i policisë me organet e pushtetit vendor përkatës, si dhe me zyrat e përmbarimit, me qëllim që të parandalohet thyerja dhe mosrespektimi i urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga gjykata.

Së gjashti, në lidhje me rolin e shoqërisë civile,

Të rritet bashkëpunimi i shoqërisë civile me organet e pushtetit qendror e vendor për parandalimin e dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave të dhunës.

Literatura:

Ligje:

1. Ligj Nr. 10 329, datë 30.9.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”.
2. Ligj nr.10039, dt. 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”.
3. Ligji nr.10329, datë 30.09.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Raporte:

1. “Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri” (raport i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë), OSBE, 2006.
2. Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, (periudha e monitorimit: 01.06.2007-31.04.2008, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2008.
3. Raport. Zbatimi i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë, 2009. (botuar në website: <http://www.qag-al.org>).
4. Vrojtimi Kombëtar i INSTAT, “Dhuna në familje në Shqipëri”, 2009.

Vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2008-2010

ⁱ Vendimi nr.6739, datë 23.07.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë